

VENDIMI ËSHTË I PLOTFUQISHËM
 QËZËPËRJA JE PRAVNOSNAŽNA
 GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD
 FERIZAJ I UROSEVAC NË EMËR TË POPULLIT

07-08-17
 GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ – DEPARTAMENTI I PËRGJITSHËM

DIVIZIONI PENAL, si gjykatë e shkallës së parë penale, me gjyqtarin individual Mustaf Tahiri si dhe me sekretaren juridike Drita Ujupë, në lëndën penale kundër të akuzuarve [REDACTED] nga fshati [REDACTED] komuna [REDACTED] dhe [REDACTED] nga fshati [REDACTED] komuna [REDACTED] për shkak të veprave penale përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 par.2 të KPRK-së dhe veprës penale në bashkëkryerje lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/1.nr.7/16 të datës 14.09.2017, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor, me datë 05.07.2017 mori dhe publikisht komunikoi ndërsa me datë 20.07.2017 përpiloi me shkrim këtë:

AKTGJYKIM

Të akuzuarit:

1. [REDACTED] nga fshati [REDACTED] Komuna [REDACTED] i lindur më [REDACTED], nga i ati [REDACTED] dhe e ëma [REDACTED] e gjinisë [REDACTED], ka të kryer fakultetin ekonomik, i martuar, prind i tre fëmijëve, i gjendjes së mirë ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me nr.përsional [REDACTED]
2. [REDACTED], nga fshati [REDACTED] Komuna [REDACTED] i lindur më [REDACTED] nga i ati [REDACTED] dhe e ëma [REDACTED] e gjinisë [REDACTED], ka të kryer shkollën e mesme, me profesion moler, i pa martuar, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës me nr.përsional [REDACTED]

JANË FAJTOR

1. I pandehuri [REDACTED]

Me datë me datë 05.02.2016, rreth orës 16.15, në oborrin e shtëpisë së tij në fshatin [REDACTED] komuna [REDACTED], në kundërshtime me ligjin e zbatueshëm mbi armët, ka përdorur në mënyrë frikësuese, në atë mënyrë që pas një konflikti në mes të pandehurit dhe të dëmtuarit [REDACTED] i dëmtuari së bashku me familjarët e tij kishin shkuar afër shtëpisë së të pandehurit me qëllim që mos të lejojnë që i pandehuri të largohet nga shtëpia, para se të vijnë policia, pasi që i dëmtuari paraprakisht kishte lajmëruar rastin e rrahjes, i pandehuri del në oborrin e shtëpisë së tij dhe kur e kupton se afër dyerve të shtëpisë gjendet i dëmtuari së bashku me disa persona tjerë, i njëjti merr armët dhe shtënë disa herë në ajër me revole dhe atë "Ecol Jackal Dual" e kalibrin 9mm, me numër serik 1550089 dhe me revolen "Parabellum" e kalibrin 9x19 mm, me numër serik 8585, me çrast të njejtat i sekuestrohen përkohësisht nga Policia.

Me të cilën kreu veprën penale përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 par.2 të KPRK-së

2. Të pandehurit [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR]

Me datë 05.02.2016, rreth orës 16.00, në rrugën e fshatit [REDAKTUAR] komuna [REDAKTUAR], në bashkëkryerje i kanë shkaktuar lëndime të lehta trupore të dëmtuarit [REDAKTUAR] në atë mënyrë që pasi i dëmtuari së bashku me [REDAKTUAR], kishin dalë nga shitorja e fshatit, duke ecur rrugës, aty ka kaluar i pandehuri me veturë, pasi e ka vërejtur të dëmtuarin, ka dalë nga vetura dhe pas një konflikti verbal mes tyre lidhur me një mosmarrëveshje të mëhershme, gjendja tensionohet, nga vetura del edhe i pandehuri [REDAKTUAR] të cilët e sulmojnë fizikisht duke e goditur me grushte në pjesë të ndryshme të trupit duke i shkaktuar lëndime të lehta trupore me pasoja të përkohshme për shëndetin.

- me të cilën në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale në bashkëkryerje lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par1 me nenin 31 të KPRK-së.

Andaj gjykata në bazë të nenit lartcekur dhe neneve 4,6,7,17,41,42,43,45,46,73, 74,75 dhe 76 të KPK-së, dhe nenit 365 të KPPK-së, të pandehurit i

GJYKON

1. Të pandehurin [REDAKTUAR]

1/a. Për veprën penale sipas pikës 1 të dispozitivit të këtij aktgjykimi i shqipton dënim burgimi në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, i cili dënim me burgim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari në afatin kohor prej 2 (dy) vite nuk përsërit vepër tjetër penale si dhe

Denim me gjobë në lartësi prej 400 (katërqind) euro.

1/ b. Për veprën penale sipas pikës 2 të këtij aktgjykimi i shqipton dënim me gjobë në lartësi prej 300 (treqind) euro,

Konform nenit 80 të KPRK-së të pandehurit [REDAKTUAR] i shqipton dënim unik me gjobë në shumën prej 700 (shtatëqind) Euro, të cilin dënim është i obliguar ta paguaj në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi si dhe

Dënim burgimi në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, i cili dënim me burgim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari në afatin kohor prej 2 (dy) vite nuk përsërit vepër tjetër penale. Ne dënimin e shqiptuar me burgim do ti llogaritet edhe koha e kaluar në ndalim prej 05.02.2016 e deri më 07.02.2017.

2. Të pandehurin [REDAKTUAR] i shqipton dënim me gjobë në lartësi prej 400 (katërqind) euro, të cilin dënim është i obliguar ta paguaj në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse dënimet e shqiptuara me gjobë nuk mund të ekzekutohet as në mënyra të tjera të parapara në nen. 46 të KPK-së, do të ekzekutohet në atë mënyrë që për çdo 20 (njëzet) €, ashtu që të pandehurit do të vuajnë një ditë burgu.

Konform nenit 375 par.3 të KPRK-së konfiskohen në mënyrë të përhershme revolet dhe atë "Ecol Jackal Dual" e kalibrit 9mm, me numër serik 1550089 dhe me revolen "Parabellum" e kalibrit 9x19 mm, me numër serik 8585.

I dëmtuari [REDAKTUAR] ka deklaruar se hek dorë nga realizimi i kërkesës pasurore-juridike.

Obligohen të akuzuarit që në emër të shpenzimeve të procedurës penale në mënyrë solidare të paguajnë shumën prej 20 euro dhe në emër të paushallit gjyqësor secili veç e veç shumën prej 20 €, të gjitha këto në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit nën kërcënimin e përbarimit me dhunë.

A r s y e t i m i

Prokuroria Themelore në Ferizaj me aktakuzën PP/I.nr.7/16 e dt. 14.09.2016 i ka ngarkuar të pandehurit [REDAKTUAR] për veprën penale përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 par.2 të KPRK-së dhe në bashkëkryerje të pandehurit [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Duke vepruar sipas kësaj çështje penale ndaj të pandehurve gjykata mbajti shqyrtimin gjyqësor fillestar më dt. 24.05.2017 në të cilin Prokurori i Shtetit Avdullah Abedini, pas leximit të aktakuzës ka deklaruar se në tërësi mbeti pranë aktakuzës duke i propozuar gjykatës që të pandehurin të i shpallë fajtor dhe të dënohen sipas ligjit.

I pandehuri [REDAKTUAR], në shqyrtimin gjyqësor fillestar, me rastin e njoftimit për të drejtën e tij që të pranoj fajësinë apo të deklarohet i pa fajshëm në kuptim të nenin 246 të KPPK-së, ka deklaruar se e pranon fajësinë për veprat penale për të gjitha pikat për të cilat e ngarkon aktakuza, duke theksuar se për këtë vepër është penduar thellë, duke kërkuar falje për atë që ka ndodhur s dhe duke premtuar se më nuk do të përsërisë veprime të tilla si dhe duke e lutur gjykatën që të shqipton ndonjë dënim sa më të butë.

I pandehuri [REDAKTUAR] në shqyrtimin gjyqësor, me rastin e njoftimit për të drejtën e tij që të pranoj fajësinë apo të deklarohet i pa fajshëm në kuptim të nenin 246 të

KPPK-së, ka deklaruar se nuk e pranon fajësinë për veprën penale për të cilat e ngarkon aktakuza.

I dëmtuari [REDACTED] ka deklaruar se pajtohen me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit [REDACTED] se tani me të akuzuarin kanë raporte të mira, se janë pajtuar mes vete, dhe hek dore nga kërkesa pasurore juridike.

Mbrojtësi i të pandehurit [REDACTED] av. [REDACTED] ka deklaruar se i mbrojturi i tij këtu i akuzuari pranimin e fajësisë e ka bere vullnetarisht dhe pasi qe paraprakisht është konsultuar me te, duke e njoftuar me natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, duke propozuar gjykatës që si rrethanë lehtësuese ti merr sjelljet e tij para kryerjes së veprës penale, pendimin dhe keqardhjen dhe premtimin gjithashtu si rrethanë posaçërisht lehtësuese gjykata të merr pranimin e fajësisë, kërkim faljen dhe marrëdhëniet tani të mira mes vete.

Me që i pandehuri [REDACTED] kanë pranuar fajësinë gjykata konstatoj se janë plotësuar të gjitha kërkesat e përcaktuara me dispozitën e nenit 248 par.1 të KPPK-së:

- I pandehuri ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit,
- pranimi është bërë vullnetarisht nga i pandehuri, pas konsultimeve me mbrojtësin e tij,
- pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit, dhe ne provat tjera te cilat gjinden ne shkresën e lëndes siç janë: mendimi dhe konstatimi i ekspertit mjeko ligjor i datës 24.02.2016, raporti i AKF/ 2016-0317/2016-265 i datës 04.08.2016 deklarata e të dëshmitarit [REDACTED] e datës 12.02.2016 e dhënë para prokurorit të shtetit, deklarata e të dëmtuarit [REDACTED] e datës 12.02.2016 e dhënë para prokurorit të shtetit, deklarata e të pandehurit [REDACTED] e datës 23.02.2016 e dhënë para prokurorit të shtetit, vërtetimet mbi sekuestrimin e sendeve të datës 05.02.2016si dhe foto Albumi nga njësia e Forenzikës, dokumentacioni i cili gjendet ne shkresat e lëndës, dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje te qarte ligjore ose gabim faktik.

Duke vepruar në këtë çështje penale gjykata me datë 04.07.2017 mbajti shqyrtimin gjyqësore, në të cilën përfaqësuesi i akuzës - prokurori i shtetit Avdullah Abedini në fillim të shqyrtimit gjyqësor lexoi aktin akuzues, ndërsa në fjalën përfundimtare prokurori i shtetit mbeti në tërësi pranë aktit dhe kualifikimit juridik të tij, duke kërkuar që i akuzuari [REDACTED] të shpallet fajtorë dhe ti përcaktohet sanksion penal i paraparë me ligj.

Të akuzuarit [REDACTED] konform nenit 325 të KPPK-së në shqyrtimin gjyqësor i është dhënë mundësia për tu deklaruar lidhur me fajësinë, ku i njëjti ka deklaruar se nuk e pranon fajësinë për veprën penale me të cilat ngarkohet, i cili në mbrojtjen e tij ka deklaruar se: me datën 05.02.2016 së bashku me [REDACTED] dhe [REDACTED] kanë qenë në fshatin [REDACTED] me veturën

██████████ për ti marrë dokumentet e firmës të ██████████ duke shkuar rrugës në fshatin ████████ dy persona na kanë ndalur përpara dhe e kanë ndalur veturën ku ishin ne unë ██████████ dhe ██████████ ██████████ ka dalë nga vetura dhe kanë filluar të përleshën ndërsa unë me ██████████ kemi dal dhe i kemi ndarë. Dëshmitari dhe i dëmtuari ██████████ dhe tani dëshmitari ██████████ kanë qenë këta persona që e kishin ndalur veturën e ██████████ nuk është e vërtetë që unë e kam goditur me thikë e as që i kam parë ndonjërit thikë në dorë.

Gjykata pas administrimit të provave në shqyrtim gjyqësor dhe vlerësimit të tyre një nga një dhe në lidhje me provat e tjera, ku në bazë të këtij vlerësimi vërtetohet gjendjen e fakteve si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjendjen faktike gjykata e vërtetoi nga dëshmia e dëshmitarit të dëmtuarit ██████████ i cili në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se: sa i përket kësaj çështje penale kam dhënë deklaratë në Stacionin Policor dhe në Prokurorin Themelore në Ferizaj, data e saktë nuk më kujtohet por e di që ka qenë muaji Shkurt rreth orës 4 kemi pasur një mosmarrëveshje të më hershme me fqin ██████████ Unë së bashku me fqin tim ██████████ kemi qenë në një shitore të fshatit, dhe deri sa kemi qenë duke ecur në këmbë ka ardhur ██████████ me veturën e tij e në veturë ka qenë ██████████ duke vozitur i pandehuri ██████████ i cili është sot prejent në këtë gjykatore dhe një person tjetër, ██████████ e ka ndalur veturën para meje dhe ██████████ së bashku me personin i cili ka qenë me flokë të bardha kanë dalë para meje ndërsa i pandehuri ██████████ më ka goditur nga mbrapa me një thikë në kokë dhe unë fatmirësisht jam rrëzuar pasi që kisha zënë në një guri mirëpo i pandehuri ██████████ ka tentuar të më godasë me thikë por unë jam larguar, pas kësaj ██████████ duke parë ngjarjen ka bërëtitur dhe e ka thirrë babin tim në emër ndërsa të pandehurit ██████████ dhe ██████████ dhe personi tjetër kanë hyrë në veturë dhe kanë shkuar në shtëpinë e ██████████ Unë në atë gjendje që kam qenë kam shkuar në shtëpi me çrast e kemi lajmëruar Policinë dhe ata kanë ardhur dhe kanë shkuar në shtëpinë e ██████████ e kanë arrestuar ██████████ ██████████ dhe një person të cilit emrin nuk ia di dhe pas kësaj Policia më ka rekomanduar që ta marrë ndihmën e parë në emergjencën në Ferizaj. Jam 100% i sigurt se i pandehuri i cili është ulur sot në këtë gjykatore ██████████ është personi i cili më ka goditur atë ditë me thikë në kokë. Sa i përket kompensimit të dëmit ndaj të pandehurit nuk parashtroi kërkesë pasuroro – juridike ndërsa i bashkëngjitëm ndjekjes penale.

Në dëshminë e tij në shqyrtim gjyqësor dëshmitarit ██████████ deklaroj se : unë për këtë çështje kam dhënë deklaratë në Prokurorin Themelore në Ferizaj duke theksuar se mbetet pranë asaj deklarate që ka dhënë, duke shtuar se data e saktë nuk i kujtohet por ka qenë së bashku me ██████████ në shitore dhe deri sa ishin duke u kthyer, vetura e kushëririt të tij ██████████ ishte ndalur para tyre dhe para tyre kishte dalë ██████████ së bashku edhe me dy persona tjerë dhe ju kanë vërsulur ██████████ dhe deri sa ██████████ dhe një person kanë qenë përpara ██████████ nga mbrapa një person nga mbrapa e ka goditur me thikë por nuk e din a e ka goditur me thikë apo me çykë të thikës e as nuk e është i sigurt nëse ka qenë i pandehuri ██████████ pasi që siq ka thënë dëshmitari i njëjti vuan nga sëmundja e sheqerit dhe në momentin kur e ka pa thikën vëmendjen e ka pasur te thika dhe pas kësaj ata janë larguar dhe dëshmitari ka deklaruar se ka vazhduar duke e thirrë babain e ██████████ I ██████████

Gjykata dëshminë e dëshmitarit- të dëmtuarit [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] e ka vlerësuar si të besueshme pasi që e njëjta është objektive, ku dëshmitari- i dëmtuari në mënyrë të saktë e ka përshkruar rastin, në mënyrë të sigurt e ka identifikuar edhe të pandehurin [REDAKTUAR] dhe e njëjta deklaratë është edhe në harmoni të plotë edhe me provat materiale siq është ekspertiza mjeko ligjore, raporti i Qendrës Emergjente i datës 05.02.2016, raporti i oficerit i datës 05.02.2016, është në përputhje edhe me deklarimin e bashkëakuzuarit [REDAKTUAR] i cili ka pranuar fajësinë se në bashkëkryerje me të akuzuarin [REDAKTUAR] ka kryer veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së dhe shkresat tjera të lëndës.

Gjykata gjithashtu vlerësoi edhe e mori në konsideratë edhe mbrojtjen e të akuzuarit [REDAKTUAR] mirëpo gjykata një mbrojtjes së tillë nuk e vlerësoi si të besueshme, sepse mbrojtja e të pandehurit është kontradiktore, nuk është e mbështetur në prova dhe fakte, por më shumë është e orientuar nga fshehja e veprimeve inkriminuese me qëllim të shmangies nga përgjegjësia penale.

Vlerësuar nga aspekti juridik gjykata gjeti se në veprimet e të pandehurit [REDAKTUAR] ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 par.2 të KPRK-së, të përshkruar si në datën, kohën dhe vendin siq është përshkruar në dispozitivin e parë këtij aktgjykimi, ku i pandehuri [REDAKTUAR] në kundërshtime me ligjin e zbatueshëm mbi armët, ka përdorur në mënyrë frikësuese, në atë mënyrë që pas një konflikti në mes të pandehurit dhe të dëmtuarit [REDAKTUAR] i dëmtuari së bashku me familjarët e tij kishin shkuar afër shtëpisë së të pandehurit me qëllim që mos të lejojnë që i pandehuri të largohet nga shtëpia, para se të vijnë policia, pasi që i dëmtuari paraprakisht kishte lajmëruar rastin e rrahjes, i pandehuri del në oborrin e shtëpisë së tij dhe kur e kupton se afër dyerve të shtëpisë gjendet i dëmtuari së bashku me disa persona tjerë, i njëjti merr armët dhe shtënë disa herë në ajër me revole dhe atë "Ecol Jackal Dual" e kalibrit 9mm, me numër serik 1550089 dhe me revolen "Parabellum" e kalibrit 9x19 mm, me numër serik 8585, me çrast të njëjtat i sekuestrohen përkohësisht nga Policia.

Po ashtu gjykata ka vlerësuar se nga aspekti juridik gjeti se në veprimet e të pandehurve [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale në bashkëkryerje lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, të përshkruar si në datën, kohën dhe vendin siq është përshkruar në dispozitivin e dytë këtij aktgjykimi, ku të pandehurit në bashkëkryerje i kanë shkaktuar lëndime të lehta trupore të dëmtuarit [REDAKTUAR] në atë mënyrë që pasi i dëmtuari së bashku me [REDAKTUAR] kishin dalë nga shitorja e fshatit, duke ecur rrugës, aty ka kaluar i pandehuri me veturë, pasi e ka vërejtur të dëmtuarin, ka dalë nga vetura dhe pas një konflikti verbal mes tyre lidhur me një mosmarrëveshje të mëhershme, gjendja tensionohet, nga vetura del edhe i pandehuri [REDAKTUAR] të cilët e sulmojnë fizikisht duke e goditur me grushte në pjesë të ndryshme të trupit duke i shkaktuar lëndime të lehta trupore me pasoja të përkohshme për shëndetin

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 73 të KPK-së, si rrethanë lehtësuese për të pandehurin [REDAKTUAR] mori pranimin e fajësisë, sjelljen e tij korrekte, pendimin e tij të shprehur për veprat penale të kryera, premtimin se në të ardhmen nuk do ta përsërisin veprimet e tyre, se raportet mes të dëmtuarit dhe të tijë janë tani të mira, familjet mes vete janë pajtuar. Ndërsa për të pandehurin [REDAKTUAR] si rrethanë lehtësuese gjykata se i njëjti është punëtor, dhe kujdeset për familjen e tij, se me të dëmtuarin nuk kanë pasur ndonjë mosmarrëveshje pas këtij rasti, ndërsa si rrethana rënduese gjykata për të dy të akuzuarit vlerësoi shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarve dhe rrezikshmerinë konkrete të veprave penale për të cilat është akuzuar i akuzuari [REDAKTUAR] si dhe veprën penale për të cilën është akuzuar i akuzuari [REDAKTUAR] andaj duke marrë parasysh tërësinë e këtyre rrethanave dhe shkallën e përgjegjësisë penale si dhe rrezikshmërinë konkrete të veprës penale, andaj mbi bazën e rrethanave të tilla gjykata konform nenit 75 dhe 76 të KPRK-së për të dy të akuzuarit bëri zbutjen e dënimit dhe dy të pandehurve u vërtetoi dënimin me burgim si në dispozitivin e këtij aktgjykimi, me bindjen se në rastin konkret do të arrihet qëllimi i dënimit të preventives speciale dhe asaj gjenerale, ku një dënim i tillë është adekuat dhe në proporcion të drejt në raport me peshën e veprës penale, rrethanave të kryerjes së veprës penale, shkallën e përgjegjësisë penale dhe personalitetin e të pandehurve.

I dëmtuari [REDAKTUAR] ka deklaruar se hek dorë nga realizimi i kërkesës pasurore-juridike.

Konform nenit 375 par.3 të KPRK-së konfiskohen në mënyrë të përhershme revolet dhe atë "Ecol Jackal Dual" e kalibrit 9mm, me numër serik 1550089 dhe me revolen "Parabellum" e kalibrit 9x19 mm, me numër serik 8585.

Konform nenit 450 par.2 nën par.2.6 dhe par.3 dhe neni 451 të KPPRK-së, të pandehurit obligohen që në emër të shpenzimeve të procedurës penale për ekspertizën mjeko ligjore në mënyrë solidare të paguajnë shumën prej 20 euro si dhe në emër të paushallit gjyqësor secili veç e veç të paguajnë shumën prej 20 euro, në afat prej 15 ditëve, nga data kur aktgjykimi të merr formën e prerë, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm

Nga arsyet e lartë përmendura është vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ- Departamenti i përgjithshëm-divizioni
penal, P.nr.854/16 dt.20.07.2017**

Sekretarja Juridike,
Drita Ujupi

Gjyqtari,
Mustaf Tahiri



KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, Gjykatës së Apelit në Prishtinë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të kopjes me shkrim të këtij aktgjykimi, për mes të kësaj gjykate.